VENDIM
Nr. 253, datë 23.8.2023

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "ERSEKA SOLAR PARK 2" SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 20 mw (AC)

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa "a", 38, pika 1, germa "a", dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "a", 5, pika 1, germa "a", 13 dhe 14, pika 9, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.8.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1888/7 prot., datë 21.8.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi licencimin e shoqërisë 'Erseka Solar Park 2' sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 mw (AC)",

konstatoi se:

- Shoqëria "Erseka Solar Park 2" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1888 prot., datë 5.7.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 230, datë 19.7.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Erseka Solar Park 2" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 20 mw (AC).

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 20.7.2023 dhe 21.7.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 18.8.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u botua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1888/3 prot., datë 21.7.2023, ERE i njoftoi shoqërisë vendimin nr. 230/2023 dhe evidentoi dokumentacionin që nevojitet të plotësohet. ERE, me shkresën nr. 1893/5 prot., datë 28.7.2023 ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "Erseka Solar Park 2" sh.p.k.

- Shoqëria, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1888/4 prot., datë 1.8.2023 dhe nr. 1888/6 prot., datë 10.8.2023, ka depozituar dokumentacion plotësues të këtij aplikimi.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e licencës sipas përcaktimeve të aneksit A të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria "Erseka Solar Park 2" sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat "a", "b" dhe "c"; për pikën 1.2, germat "a", "b", "c" dhe "d"; për pikën 1.3, germat "a", "b" dhe "c"; për pikën 2.1, germat "a", "b", "c", "d", "e" dhe "f".

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa "a" të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa "a" të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Në rastin konkret shoqëria ka plotësuar në formatin përkatës afatin e pritshmërisë së jetëgjatësisë së centralit 35 vjet, ndërkohë që rezulton se ka dokumentuar që garancia e tij është 30

vjet, ndaj në këto rrethana ERE kushtëzohet nga parashikimet ligjore dhe garancia për jetëgjatësinë e centralit në përcaktimin e afatit të vlefshmërisë së licencës, pra për 30 vjet.

- Për sa parashikohet në VNM-në paraprake, në lidhje me zbatimin në terren të projektit, vlerësohet që t'i lihet kusht shoqërisë të informojë ERE-n çdo 3 (tre) muaj, në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaik, deri më datë 21.2.2024 (datë në të cilën përfundon dhe vlefshmëria e kësaj VNM-je).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Erseka Solar Park 2" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 mw (AC), për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria të informojë ERE-n çdo 3 (tre) muaj, në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaik, deri më datë 21.2.2024.

3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të depozitimit të informacionit sipas përcaktimeve të pikës 2, në kuadër të vlefshmërisë së VNM-së paraprake.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "Erseka Solar Park 2" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti